**UDHËZIM**
**Nr. 8, datë 21.2.2025**

# PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 23, DATË 20.9.2024, PËR RREGULLAT PËR MASAT E VEÇANTA TË KONTROLLIT PËR VENDOSJEN E MASAVE PËR ÇRRËNJOSJE DHE PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË KALBËZIMIT UNAZOR TË PATATES *CLAVIBACTER SEPEDONICUS* (SPIECKERMANN&KOTTHOFF 1914) NOUIOUI *ET AL*. 2018[1]

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në pikën 3, të nenit 8, të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 23, datë 20.9.2024, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 6, pika 1 paragrafi i parë zëvendësohet me formulimin si më poshtë:

"1. Bimët e specifikuara, të përcaktuara si të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar në përputhje me shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 5, nuk do të mbillen. Operatorët profesionistë nën mbikëqyrjen e AKVMB-së, garantojnë që bimët e specifikuara të infektuara të shkatërrohen ose të asgjësohen në një mënyrë tjetër, në përputhje me pikën 1, të aneksit V, bashkëlidhur këtij udhëzimi, me kusht që të vërtetohet se nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesit të specifikuar";

2. Në nenin 3, të pikës 3, pas shkurtesës AKVMB togfjalëshi "i raporton" zëvendësohet me togfjalëshin "ISUV dhe AKU, sipas përgjegjësisë i raportojnë".

3. Aneksi II zëvendësohet me aneksin bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
**Anila Denaj**

---

[1] Ky udhëzim përafron plotësisht rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2024/2636, e datës 8 tetor 2024, që ndryshon rregulloren zbatuese (BE) 2022/1194 në lidhje me përgjegjësitë e operatorëve profesionistë dhe formatin për të raportuar rezultatet e vrojtimit të *Clavibacter sepedonicus* (Spiecker sepedonicus &9.4. 2018).

# ANEKSI II
## Formati i vrojtimit referuar në pikën 3, të nenit 3

Formati për paraqitjen e rezultateve të vrojtimeve të kalbëzimit unazor të kryera gjatë vitit kalendarik që i paraprin vitit të raportimit.

| Rajoni | Kategoria | Zona e mbjelljes (ha) | Inspektime vizuale të kulturave në rritje | | | | | Inspektimet vizuale të lot-eve të zhardhokëve në magazinë [a] | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Zona e inspektuar vizualisht (ha) | Numri i inspektimeve vizuale [c] | Numri i inspektimeve vizuale ku janë vëzhguar simptoma [ç] | Numri i mostrave simptomatike të marra [d] | Numri i mostrave asimptomatike të marra [d] | Numri i inspektimeve vizuale [c] | Numri i inspektimeve vizuale ku janë vëzhguar simptoma [dh] | Numri i mostrave simptomatike të marra [d] | Numri i mostrave asimptomatike të marra [d] |
| | Zhardhokët e patates për mbjellje [b] | | | | | | | | | | |
| | Zhardhokët e patates të destinuara të destinuara për t'u mbjellë në vendin e tyre të prodhimit | | | | | | | | | | |
| | Zhardhokët e patates përveç atyre për mbjellje | | | | | | | | | | |

| Labo | Kategoria | Testet laboratorike në lidhje me inspektimet | Testet laboratorike në lidhje me | Numrat e | |
|---|---|---|---|---|---|

| | | vizuale të kulturave në rritje | | | inspektimet e grupit të zhardhokëve | | | njoftimit të shpërthimeve të reja të njoftuara, sipas rastit, në përputhje me nenin 15 të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar | Informacione shtese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Numri i mostrave simptomatike Testuar pozitiv** | **Numri i mostrave asimptomatike të testuar pozitiv** | **Numri i inspektimeve vizuale pozitive (e)** | **Numri i mostrave simptomatike të testuar pozitiv** | **Numri i mostrave asimptomatike të testuar pozitiv** | **Numri i lot-eve pozitiv** | | |
| | Zhardhokët e patates për mbjellje (b) | | | | | | | | |
| | Zhardhokët e patates të destinuara për t'u mbjellë në vendin e tyre të prodhimit | | | | | | | | |
| | Zhardhokët e patates përveç atyre për mbjellje | | | | | | | | |

_____.

(a) Të plotësohet vetëm për rezultatet e vrojtimeve të kryera në bimë të specifikuara të rritura dhe të vjela në rajonin përkatës.

(b) Përveç zhardhokëve të destinuara për t'u mbjellë në vendin e tyre të prodhimit.

(c) Duke përfshirë numrin e inspektimeve të shumëfishta vizuale të kryera në të njëjtën fushë ose në të njëjtin lot, sipas rastit.

(ç) Simptomat u gjetën në zhardhokët ose bimët e prera dhe mostrat u morën për testim laboratorik.

(d) Përgatitja e mostrës përshkruhet në aneksin I, pika 4.

(dh) Simptomat u gjetën në zhardhokët e prerë dhe mostrat u morën për testim laboratorik.

(e) Numri total i inspektimeve vizuale për të cilat mostrat u testuan pozitivisht për praninë ose *C. sepedonicus*.